



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

PROJEKTLIGJI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT¹

DRAFT LAW ON CONSUMER PROTECTION²

NACRT ZAKON O ZA ZAŠTITU POTROŠAČA³

¹ Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit, është miratuar në mbledhjen e73-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin nr.01/73 me date 07.05.2012.

² Draft Law on consumer protection, was approved in the 73th meeting of the Government of Republic of Kosovo with the decision no.01/73 dtd. 07.05.2012

³ Nacrt zakona o za zaštitu potrošača, usvojen je na 73-oj sednici Vlade Republike Kosova, odlukom br. 01/73 od 07.05.2012



<p style="text-align: center;">REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miratton</p> <p style="text-align: center;">LIGJIN PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT</p> <p style="text-align: center;">KREU I</p> <p style="text-align: center;">DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Ky ligji rregullon mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit, shëndetin publik, mjedisin, sigurinë e jetës, përcakton rregullat për blerjen e mallrave dhe shërbimeve në treg si dhe detyrimet e shitësit, prodhuesit dhe furnizuesit.</p>	<p style="text-align: center;">THE REPUBLIC OF KOSOVO THE ASSEMBLY</p> <p>Pursuant to article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves</p> <p style="text-align: center;">LAW ON CONSUMER PROTECTION</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER I</p> <p style="text-align: center;">GENERAL PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>This law regulates the protection of consumer rights, public health, environment, safety of life, sets out the rules for purchasing commodities and services in the market and obligations of the seller, manufacturer and supplier.</p>	<p style="text-align: center;">REPUBLIKA KOSOVO SKUPŠTINA</p> <p>U podršci članu 65 (1) Ustava Republike Kosova,</p> <p>Odobrava</p> <p style="text-align: center;">ZAKON O ZA ZAŠTITU POTROŠAČA</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE I</p> <p style="text-align: center;">OPŠTE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>Ovaj zakon uređuje zaštitu prava potrošača, javno zdravlje, sredinu, sigurnost života, utvrđuje pravila za kupovinu roba i usluga na tržište kao i obaveze prodavca, proizvođača i dobavljača.</p>
---	--	--



<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>1. Ky ligj është i zbatueshëm për çdo konsumator i cili ka vendbanim në Republikën e Kosovës si dhe personave tjerë jorezident të cilëve nuk mund t’iu mohohet mbrojtja e të drejtave të cilat i garanton ky ligj, ligjet dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë fusha të caktuara të mbrojtjes së konsumatorit.</p> <p>2. Ky ligj zbatohet për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet konsumatorëve nga njëra anë dhe prodhuesve, shitësve, furnizuesve, ofruesve të shërbimeve nga ana tjetër për ta mbrojtur konsumatorin nga praktikat e padrejta në tregun e mallrave dhe të shërbimeve në Republikën Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope of Application</p> <p>1. This law is applicable to any consumer who has a residence in the Republic of Kosovo and other non-resident persons who can not be denied the protection of rights guaranteed by this law, other laws and bylaws regulating certain areas of consumer protection.</p> <p>2. This law applies to the regulation of relations between consumers on one hand and manufacturers, sellers, suppliers, service providers on the other hand to protect the consumer from unfair trading practices in the market of commodities and services in the Republic of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Oblast primene</p> <p>1. Ovaj zakon je primenjiv za svakog potrošača koji ima prebivalište u Republici Kosova i za ostala nerezidentna lica kojima se ne mogu negirati prava koja garantuje ovaj zakon, zakoni i ostali podzakonski akti koji regulišu određene oblasti za zaštitu potrošača.</p> <p>2. Ovaj zakon se sprovodi za regulisanje odnosa između potrošača sa jedne strane i proizvođača, prodavca, dobavljača i davaoca usluga sa druge strane, kako bi se zaštitio potrošač od nepravednih trgovinskih praksi na tržištu roba i usluga u Republici Kosova.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimi</p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. Konsumator - nënkupton çdo person fizik i cili blen dhe përdor mallra ose shërbime për plotësimin e nevojave të</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definition</p> <p>1. Terms used in this Law have the following meaning:</p> <p>1.1. Consumer - means any natural person who buys and uses commodities or services to fulfill their needs, for purposes</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definisanje</p> <p>1. Izrazi upotrebljeni u ovom zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. Potrošač- podrazumeva svako fizičko lice koje kupuje i koristi robe ili usluge za ispunjavanje svojih potreba , za potrebe</p>



<p>veta, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare;</p> <p>1.2. Tregtar - nënkupton çdo person fizik apo juridik që shet ose vepron në treg si biznes apo ushtron e veprimtarinë e tij tregtare, si një person që vepron në emër ose për llogari të një tregtari me shumicë apo të një prodhuesi;</p> <p>1.3. Ofrues i shërbimeve - nënkupton personin që shet mallra apo u ofron shërbime konsumatorit;</p> <p>1.4. Furnizues - nënkupton çdo prodhues, person fizik apo juridik që ofron mallra tek shitësit;</p> <p>1.5. Mall i lirë ose refuz - nënkupton mallin që i është ofruar për shitje konsumatorit, i pa paketuar dhe matet në prani të konsumatorit</p> <p>1.6. Mall i para paketuar - nënkupton mallin e shitur me ambalazh i cili pa përpunim të mëtejshëm i ofrohet konsumatorit të fundit;</p> <p>1.7. Mall - nënkupton çdo produkt apo shërbim që i ofrohet konsumatorit;</p>	<p>that have no connection with commercial activity;</p> <p>1.2. Trader - means any natural or legal person who sells or operates in the market as a business or exercises its commercial activity, as a person acting on behalf or for the account of a wholesaler or a manufacturer;</p> <p>1.3. Service Provider - means a person who sells commodities or provides services to a consumer;</p> <p>1.4. Supplier - means any manufacturer, natural or legal person that provides commodities to the seller;</p> <p>1.5. Free or bulk commodity - means the commodity which are offered for consumer sale, unpackaged and measured in the presence of the consumer;</p> <p>1.6. Pre-packed commodity - means the commodities sold as packed which without further processing is offered to the final consumer;</p> <p>1.7. Commodity – means any commodities/product or service provided to the consumer;</p>	<p>koje nemaju veze sa trgovinskom delatnošću;</p> <p>1.2. Trgovac-podrazumeva svako fizičko ili pravno lice koje prodaje ili deluje na tržištu kao poslovanje ili vrši svoju trgovinsku delatnost kao jedno lice koje deluje u ime ili za račun jednog trgovca na veliko ili jednog proizvođača;</p> <p>1.3.Davalac usluga - podrazumeva lice koje prodaje robe ili pruža usluge potrošaču;</p> <p>1.4.Dobavljač - podrazumeva svakog proizvođača, fizičko ili pravno lice koje pruža robu prodavcu;</p> <p>1.5. Slobodan ili neupakovan roba-podrazumeva robu koji je dat za prodaju potrošaču, neupakovan i meri se u prisustvu potrošača ;</p> <p>1.6. Preupakovani roba- podrazumeva prodatu robu sa ambalažom koji se bez dalje prerade pruža poslednjem potrošaču;</p> <p>1.7. Roba - podrazumeva svaku robu ili uslugu koja se nudi potrošaču;</p>
---	---	--



<p>1.8. Etiketa - nënkupton informacionin me të dhënat për prodhuesin, adresën e tij, emërtimin e mallit, sasinë, përbërjen, cilësinë, datën e prodhimit, afatin e përdorimit, mënyrën e përdorimit, mirëmbajtjen dhe rrezikshmërinë.</p> <p>1.9. Paketimi - nënkupton paketimin e sigurt për shëndetin dhe përshtatshmërinë me vëllimin dhe peshën e mallit;</p> <p>1.10. Deklaracioni i mallit - nënkupton të dhënat e vendosura në etiketën e mallit lidhur me emrin tregtar shenjën mbrojtëse dhe adresën e prodhuesit;</p> <p>1.11. Shitja përmes Aksionit- nënkupton shitjen e cila realizohet për sasi të caktuar të një malli nga një prodhues në një kohë dhe vend të veçantë, me një çmim më të ulëtse çmimi i këtij malli në një shitje të rregullt.</p> <p>1.12. Praktika e padrejtë tregtare ndaj konsumatorit - nënkupton çdo veprim apo lëshim të kryer nga shitësi ose ofruesi i shërbimeve, në komunikimin zyrtar me konsumatorin, duke përfshirë reklamat dhe marketingun e mallit të lidhur</p>	<p>1.8. Label - means information with data about the manufacturer, its address, name of commodities, quantity, composition, quality, production date, expiry date, method of use, maintenance and risk;</p> <p>1.9. Packing - means the safe packaging for the health and suitability with the volume and weight of the commodity;</p> <p>1.10. Declaration of commodities - means the data placed on the commodity label regarding the trademark, protected mark and address of the manufacturer;</p> <p>1.11. Sale through Action – means a sale implemented for a certain quantity of a commodity of a manufacturer at certain time and place, with a lower price than the price of this commodity during a regular sale.</p> <p>1.12. Unfair commercial practices towards consumer - means any act or omission committed by the seller or service provider, in official communication with the consumer, including advertising and marketing of</p>	<p>1.8. Etiketa – podrazumeva informaciju o podacima proizvođača, njegovu adresu, naziv robe, količinu, sastav, kvalitet, datum proizvodnje, rok upotrebe, način upotrebe, održavanje i opasnost;</p> <p>1.9. Paketiranje- podrazumeva sigurno pakovanje za zdravlje i prilagodljivost sa obimom i težinom roba;</p> <p>1.10. Deklaracija robe - podrazumeva podatke postavljene na etiketi robe u vezi sa trgovinskim nazivom, zaštitnim znakom i adresom proizvođača;</p> <p>1.11. Prodaja putem akcije - podrazumeva prodaju koja se realizuje za određenu količinu jedne robe od jednog proizvođača u jedno vreme i na posebnom mestu, sa jednom najnižom cenom u odnosu na cenu ove robe u jedno redovnoj prodaji;</p> <p>1.12. Nepravедna praksa prema potrošaču- podrazumeva vako radnju ili propust izvršene od prodavca ili davaoca usluga, u službenoj komunikaciji sa potrošačem, uključujući reklame i marketing robe u vezi sa neposrednim</p>
---	---	--



<p>drejtpërdrejt me promovimin e shitjes ose ofrimit të mallrave për konsumatorin;</p> <p>1.13. Ndikimi në sjelljen e konsumatorit - nënkupton përdorimin e praktikave mashtruese që në masë të madhe zvogëlojnë aftësinë e konsumatorit për të marrë një vendim të bazuar në informacion të plotë të shitësit dhe ndikon te konsumatori që të merr një vendim të cilin në rrethana tjera nuk do ta merrte;</p> <p>1.14. Reklamimi i mallrave dhe shërbimeve - nënkupton çdo reklamë apo publikim në çdo formë brenda profesionit apo të veprimtarisë së tij tregtare ose shërbyese, duke u fokusuar në promovimin e një malli apo shërbimi;</p> <p>1.15. Çmimi i mallit për njësi - nënkupton çmimin përfundimtar, përfshirë TVSH-në dhe të gjitha taksat e tjera, për një kilogram, një litër, një metër, një metër katror, një metër kub të mallit, ose për një njësi të veçantë matese si pjesë e njësive matëse ligjore, të aplikuara në Republikën e Kosovës për tregtimin e mallrave specifike;</p> <p>1.16. Garanci kontraktuale - nënkupton</p>	<p>commodity directly related with the promotion of sale or delivery of commodities to the consumer;</p> <p>1.13. Influence on consumer behavior - means the use of misleading practices that greatly reduce the ability of consumer to make a decision based on full information of the seller and influences the consumer to take a decision which in other circumstances he would not have taken;</p> <p>1.14. Advertising of commodities and services - means any advertisement or publication in any form within the profession or its commercial or service activity, focusing on promoting a commodity or service;</p> <p>1.15. The price of commodity per unit - means the final price, including VAT and all other taxes, for one kilogram, one liter, one meter, one square meter, one cubic meter of commodity, or for a particular unit as part of legal measuring units, applied in the Republic of Kosovo for the trading of specific commodities;</p> <p>1.16. Contractual warranty - means the</p>	<p>promovisanjem prodaje ili pružanja roba za potrošača.</p> <p>1.13. Uticaj na ponašanje potrošača-podrazumeva korišćenje praksi prevare što u velikoj meri smanjuje sposobnost potrošača za donošenje jedne odluke zasnovane na punoj informaciji prodavca i utiče na potrošača da donese jednu odluku koju u drugim okolnostima ne bi preduzeo;</p> <p>1.14. Reklamiranje roba i usluga - podrazumeva svaku reklamu ili publikaciju u svakoj formi unutar profesije ili njegove trgovinske ili uslužne delatnosti, usredsređujući se na promovisanje jedne robe ili usluge;</p> <p>1.15. Cena robe po jedinici - podrazumeva konačnu cenu, uključujući PDV i sve ostale takse, za jedan kilogram, jedan litar, jedan metar, jedan kvadratni metar, jedan kubni metar robe, ili za jednu posebnu jedinicu kao deo zakonskih mernih jedinica, primenjenih u Republici Kosova za trgovinu specifičnim robama;</p> <p>1.16. Ugovorna garancija - podrazumeva</p>
--	--	---



<p>detyrimin e prodhuesit, shitësit apo ofruesit të shërbimeve ndaj konsumatorit, për rimbursimin e çmimit të paguar ose për zëvendësimin apo për riparimin e mallit ose permiresimin e shërbimit në rast të mangësive, në përputhje me kushtet e vëna në deklaratën e garancisë ose në publicitetin përkatës;</p> <p>1.17. Ftesë për të blerë - nënkupton çdo formë të komunikimit të prodhuesit, shitësit apo ofruesit të shërbimeve me konsumatorin ku përshkruhen karakteristikat bazë të mallit dhe çmimit të tij, e cila i jep konsumatorit mundësi për të blerë mallin;</p> <p>1.18. Ndikim i padrejtë - nënkupton shfrytëzimin e dominimit tek konsumatori dhe përdorimin e presionit, duke e shtyrë atë që të marrë një vendim të cilin nuk do ta merrte në kushte normale;</p> <p>1.19. Zgjidhja e konflikteve jashtë gjyqësorit - nënkupton zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorit, tregtarit dhe ofruesit të shërbimeve që rezultojnë nga shkelja e zakoneve, kodeve dhe normave të mirëfillta afariste për mallin ose shërbimet për të cilat konsumatori mund të ankohet në gjykatat</p>	<p>obligation of manufacturer, seller or provider of services to the consumer, to refund the price paid or to replace or repair the commodities in case of deficiencies, in accordance with conditions set in the declaration of guarantee or relevant advertising;</p> <p>1.17. Invitation to purchase - means any form of communication of manufacturer, seller or service provider with consumers describing the basic characteristics of the commodity and its price, which gives consumers the opportunity to buy the commodity;</p> <p>1.18. Unfair influence - means the use of dominance on the consumer and the use of pressure, prompting him to take a decision which he would not have taken under normal conditions;</p> <p>1.19. Extrajudicial dispute resolution - means the resolution of disagreements between the consumer and the trader resulting from the violation of customs, codes and genuine business norms for commodities or services for which the consumer may appeal to the arbitration courts in Kosovo Chamber of Commerce</p>	<p>obavezu proizvođača, prodavca ili davaoca usluga prema potrošaču, za regenerisanje plaćene cene ili za zamenu ili za popravku robe u slučaju nedostataka, u skladu sa uslovima postavljenim u deklaraciji garancije ili na odgovarajućem publicitetu;</p> <p>1.17. Poziv za kupovinu -podrazumeva svaku formu komuniciranja proizvođača, prodavca ili davaoca usluga sa potrošačem gde su opisane osnovne karakteristike robe i njene cene, koja daje potrošaču mogućnost za kupovinu robe;</p> <p>1.18. Nepravedan uticaj –podrazumeva iskorišćavanje dominacije potrošača i upotreba pritiska, podstičući ga da donese jednu odluku koju ne bi doneo u normalnim uslovima;</p> <p>1.19. Vansudsko rešavanje konflikata - podrazumeva rešavanje nesporazuma između potrošača i trgovca koji proizilaze iz kršenja običaja, kodeksa i pravilnih poslovnih normi za robe ili usluge za koje se potrošač može žaliti u arbitražnim sudovima u Privrednoj komori Kosova i Američkoj privrednoj komori za njihovo</p>
--	--	---



<p>e arbitrazhit për zgjidhjen e tyre për mbrojtjen e të drejtave të tyre të garantuara me këtë ligj dhe ligjet tjera ne fuqi;</p> <p>1.20. Shërbime publike - nënkupton shpërndarjen e energjisë elektrike, furnizimin me energji elektrike, furnizimin me ngrohje, furnizimin me ujë, trajtimin e ujërave të zeza dhe të kullimit, transportimin e udhëtarëve në transportin publik, shërbimet postare dhe të telekomunikacionit, shërbimet shëndetësore, pastrimin e hapësirave publike, asgjësimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e varrezave.</p> <p>1.21. Kredidhënës – nënkupton secilin institucion financiar të autorizuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për dhënien e kredive;</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Të drejtat e konsumatorit</p> <p>1. Të drejtat themelore të konsumatorit sipas këtij ligji garantojnë:</p> <p>1.1. të drejtën për të mbrojtur interesat ekonomike të konsumatorit;</p>	<p>and American Chamber of Commerce to resolve them in order to protect their rights guaranteed by this law and other laws;</p> <p>1.20. Public services - means the distribution of electricity, electricity supply, heat supply, water supply, wastewater treatment and drainage, transportation of passengers in public transport, postal services and telecommunications, health services, cleaning of public spaces, destruction of waste, maintenance of cemeteries.</p> <p>1.21. Creditor - means any financial institution authorized by the Central Bank of the Republic of Kosovo to grant loans;</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Consumer rights</p> <p>1. Basic consumer rights under this Law guarantee:</p> <p>1.1. the right to protect the economic interests of consumers;</p>	<p>rešavanje za zaštitu svojih prava zagaranovanih ovim zakonom i ostalim zakonima.</p> <p>1.20. Javne usluge – podrazumeva preraspodelu električne energije, snabdevanje električnom energijom, snabdevanje grejanjem, snabdevanje vodom, tretiranje otpadnih voda i filtiranje, prevoz putnika javnim prevozom, poštanske i telekomunikacione usluge, zdravstvene usluge, čišćenje javnih površina, uništavanje otpada, održavanje grobova.</p> <p>1.21. Poverilac – podrazumeva svaku finansijsku instituciju ovlašćenu od Centralne banke Republike Kosova za davanje kredita;</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Prava potrošača</p> <p>1. Osnovna prava potrošača shodno ovom zakonu garantuju:</p> <p>1.1. prava za zaštitu ekonomskih interesa potrošača;</p>
---	--	--



<p>1.2. të drejtën për te mbrojtur nga rreziku jetën, shëndetin dhe pronën;</p> <p>1.3. të drejtën për mbrojtje ligjore të konsumatorit;</p> <p>1.4. të drejtën për tu ankuar;</p> <p>1.5. të drejtën për kompensim në raste të caktuara edhe për dëmshpërblim;</p> <p>1.6. të drejtën për informim dhe edukim të konsumatorit;</p> <p>1.7. të drejtën për shfrytëzimin e shërbimeve publike;</p> <p>1.8. të drejtën e organizimit në shoqata të konsumatorit për të mbrojtur interesat e tyre;</p> <p>1.9. të drejtën për të përfaqësuar interesat e konsumatorit, për të marrë pjesë në punën që kanë të bëjnë me çështjet e interesat e tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Detyrimet e shitësit</p> <p>1. Shitësi përmbush detyrimet ndaj konsumatorit në përputhje me dispozitat e</p>	<p>1.2. the right to be protected from danger the life, health and property;</p> <p>1.3. the right to legal protection of consumer;</p> <p>1.4. the right to complain;</p> <p>1.5. the right to compensation in certain cases for indemnity;</p> <p>1.6. the right to consumer information and education;</p> <p>1.7. the right to use public services;</p> <p>1.8. the right of organization in consumer association, to protect their interests;</p> <p>1.9. the right to represent consumer interests, to take part in the works dealing with issues of their interests.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Obligations of the seller</p> <p>1. The seller shall fulfill obligations toward the consumer in accordance with the</p>	<p>1.2. prava radi zaštite života od opasnosti, zdravlje ili imovine;</p> <p>1.3. prava na zakonsku zaštitu potrošača;</p> <p>1.4. pravo za podnošenje žalbe;</p> <p>1.5. prava za nadoknadu odštete u određenim slučajevima;</p> <p>1.6. prava na informisanje i obrazovanje potrošača;</p> <p>1.7. prava na korišćenje javnih usluga;</p> <p>1.8. prava organizovanja u udruženjima potrošača za zaštitu njihovih interesa;</p> <p>1.9. prava zastupanja interesa potrošača, radi učešća u poslovima koji se donose o pitanjima od njihovog interesa.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Obaveze prodavca</p> <p>1. Prodavac ispunjava obaveze prema potrošaču u skladu sa odredbama ovog</p>
---	--	--



<p>këtij ligji, ligjeve dhe akteve tjera nënligjore.</p> <p>2. Shitësi me kërkesë të konsumatorit pas konstatimit të të metave të mallit obligohet të bëjë zëvendësimin e mallit ose rimbursimin e të hollave të paguara për mallin ose me pëlqimin e konsumatorit, të ul çmimin për të eliminuar mungesën e mallit.</p> <p>3. Shitësi për shkak të mangësive në shërbimet e kryera, me kërkesën e konsumatorit është i obliguar për t'ia kthyer shumën e paguar për shërbimin, të eliminojë mangësitë në shërbimet e ofruara, apo të zbrit çmimin sipas marrëveshjes me konsumatorin.</p> <p>4. Konsumatori sipas paragrafit 2 dhe 3 këtij neni, mund të kërkojë kthimin e shumës së paguar vetëm nëse i kishte dhënë më parë shitësit një afat të arsyeshëm për eliminimin e të metave të mallit ose shërbimit për përmbushjen e kontratës.</p> <p>5. Në rast të kontesti, mangësitë e mallit apo shërbimit të kryer vërtetohen me anë të dëshmisë së ekspertit gjyqësor ose me ndihmën e një vlerësuesi tjetër të certifikuar. Shpenzimet e ekspertizës do të mbuloj</p>	<p>provisions of this Law, other laws and bylaws.</p> <p>2. The seller, at the request of the consumer after the conclusion for the shortcomings of the commodity is obliged to replace the commodity or refund the money paid for the commodity or with the consent of the consumer, to reduce the price to eliminate the shortcoming of the commodity.</p> <p>3. The seller due to shortcomings in services provided, at the request of the consumer, is obligated to return the amount paid for the service, to eliminate the shortcomings in services provided, or reduce the price as agreed with the consumer.</p> <p>4. Consumer pursuant to paragraph 2 and 3 of this Article may require the repayment of the amount paid only if the seller had been given a reasonable deadline for eliminating the defects of the commodity or service to fulfill the contract.</p> <p>5. In case of dispute, the defects of the commodity or service provided are certified through the evidence of court expert or through the assistance of another certified appraiser. The costs of expertise will be</p>	<p>zakona, zakona i ostalih podzakonskih akata.</p> <p>2. Prodavac na zahtev potrošača nakon utvrđivanja nedostatka robe, obavezuje se da izvrši zamenu robe ili regenerisanje plaćenih novčanih sredstava za robu ili uz saglasnost potrošača, da snizi cenu kako bi eliminisao nedostatak roba.</p> <p>3. Prodavaczbog nedostataka u izvršenim uslugama, na zahtev potrošača obavezan je da vrati plaćeni iznos za uslugu, da eliminiše nedostatke u pruženim uslugama, ili da snizi cenu shodno sporazumu sa potrošačem.</p> <p>4. Potrošač shodno stavu 2 i 3 ovog člana, može zahtevati vraćanje plaćenog iznosa samo ako je dao prethodno prodavcu jedan obrazložljiv rok za eliminisanje nedostataka robe ili usluge za ispunjenje ugovora.</p> <p>5. U slučaju spora, nedostaci robe ili obavljene usluge, utvrđuju se dokazivanjem sudskog eksperta ili uz pomoć jednog sertifikovanog ocenjivača. Troškove ekspertize će pokriti potrošač ili trgovac, u</p>
---	--	--



<p>konsumatori ose tregtari, në varësi të rezultatit të ekspertizës.</p> <p>6. Nëse shitësi gjatë periudhës së garancionit nuk mund të riparoj mallin e dëmtuar për të cilin ka dhënë garancionin, atëherë obligohet që konsumatorit t'i japë mallin e ngjashëm apo t'ia kthej mbrapa të hollat me dëmshpërblim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Kërkesat e sigurisë së përgjithshme të mallrave dhe shërbimeve</p> <p>1. Prodhuesit dhe shitësit të vendosin në treg vetëm mallra të sigurta, në përputhje me Ligji nr.04/L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe Ligji nr.04/L-039 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.</p> <p>2. Ofruesit e shërbimeve ofrojnë vetëm shërbime të sigurta, duke marrë parasysh:</p> <p>2.1. karakteristikat e shërbimit;</p> <p>2.2. efektin e shërbimit mbi mallrat dhe shërbimet e tjera;</p> <p>2.3. paraqitjen e shërbimeve,</p>	<p>covered by the consumer or trader, depending on the result of expertise.</p> <p>6. If during the warranty period the seller cannot repair the defective commodity for which he has given a guarantee, then he is obliged to give the consumer a similar commodity or to return the money back with the compensation.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 General safety requirements of commodities and services</p> <p>1. Manufacturers and sellers are obliged to place on the market only safe commodities, in accordance with the Law No. 04/L-078 on the general product safety and Law No. 04/L-039 on technical requirements for products and conformity assessment.</p> <p>2. Service providers provide only safe services, taking into consideration:</p> <p>2.1. service characteristics;</p> <p>2.2. effect of service on other commodities and services;</p> <p>2.3. presentation of services, warnings or</p>	<p>zavinosti od rezultata ekspertize.</p> <p>6. Ako prodavac tokom garantnog roka ne može popraviti oštećenu robu za koju je dao garanciju, onda se obavezuje da potrošaču da sličnu robu ili da mu vrati novac uz obeštećenje.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Zahtevi opšte sigurnosti roba i usluga</p> <p>1. Obavezuju se proizvođači i prodavci da na tržište plasiraju samo sigurne robe, u skladu sa Zakonom br. 04/L-078 o opštoj sigurnosti proizvoda i Zakona br. 04/L-039 o tehničkim zahtevima za proizvode i procenu usaglašenosti.</p> <p>2. Davaoci usluga pružaju samo sigurne usluge, imajući u obzir:</p> <p>2.1. karakteristike usluge;</p> <p>2.2. efekat usluge na robe i ostale usluge;</p> <p>2.3. podnošenje usluga, upozorenja ili</p>
--	--	---



<p>paralajmërimet ose informacionin në lidhje me shërbimet;</p> <p>2.4. kategoritë e konsumatorëve të rrezikuar, kur përdorin shërbimin, veçanërisht fëmijët dhe të moshuarit si konsumatorët me ndjesi të veçantë ndaj disa, mallrave dhe shërbimeve ndaj të sëmurit;</p> <p>2.5. rreziqet e mundshme që mund të shkaktojë shërbimi nëse nuk përdoret siç duhet.</p>	<p>information about services;</p> <p>2.4. categories of consumers at risk when using the service, especially children and the elderly as consumers with particular sensitivity towards several commodities and services against the patient.</p> <p>2.5. potential risks that could be caused by the service if not used properly.</p>	<p>informacije u vezi sa uslugama;</p> <p>2.4. kategorije ugroženih potrošača, gde koriste uslugu, posebno deca i stara lica kao potrošači sa posebnim osjetilima prema nekim robama, i uslugama prema bolesniku;</p> <p>2.5. moguće opasnosti koje može izazvati usluga ako se ne koristi kako treba.</p>
<p>KREU II</p> <p>SHITJA E MALLRAVE DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE</p> <p>Neni 7</p> <p>Kushtet e shitjes së mallrave dhe ofrimit të shërbimeve</p>	<p>CHAPTER II</p> <p>SALE OF PRODUCTS AND PROVISION OF SERVICES</p> <p>Article 7</p> <p>Conditions of the sale of commodities and provision of services</p>	<p>POGLAVLJE II</p> <p>PRODAJA PROIZVODA I PRUŽANJE USLUGA</p> <p>Član 7</p> <p>Uslovi za prodaju roba i pružanje usluga</p>
<p>1. Ekspozimi i mallit i cili në pikën e shitjes paraqitet si eksponat, nuk konsiderohet ofertë dhe tregtari mund të refuzojë shitjen e atij malli. Ofruesi i shërbimeve mund të refuzojë shërbimin që është subjekt i biznesit të tij, varësisht nga rrethanat specifike të rastit.</p>	<p>1. Exposure of the commodity which in the point of sale is presented as an exhibit, is not considered as an offer and the seller may refuse the sale of that commodity. The service provider may refuse the service which is subject to its business, depending on the specific circumstances of the case.</p>	<p>1. Izlaganje robe koji se na prodajnom mestu predstavlja kao eksponat, ne smatra se ponudom i trgovac može odbiti prodaju te robe. Davalac usluga može odbiti uslugu koja je predmet njegovog poslovanja, u zavisnosti od specifičnih okolnosti slučaja.</p>



<p>2. Shitësi duhet të ofroj kushtet e shitjes të mallrave apo shërbimeve në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme dhe ti paraqes në momentin e ekspozimit të tyre në hapësirën e shitjes. Kushtet e veçanta për kategori të caktuara të konsumatorëve që ofron tregtari, për mallin e caktuara duhet të jenë të qarta, të dukshme dhe të lexueshme dhe të shfaqen në momentin e shfaqjes së tyre në pikat e shitjes së këtyre mallrave.</p> <p>3. Shitësit i ndalohet publikimi i të dhënave apo çfarëdo informacioni personal për konsumatorin, ndonjë palë të tretë pa pëlqimin dhe autorizimin me shkrim të konsumatorit, përveç me vendim të gjykatës kur informatat i nevojiten organeve kompetente për hetimin e rasteve.</p> <p>4. Ofruesi i shërbimeve për çdo riparim dhe mirëmbajtje të mallrave duhet t'i lëshojë një faturë konsumatorit me përshkrim të shërbimeve dhe të materialeve të përdorura për riparim. Fatura duhet të nënshkruhet nga ofruesi i shërbimeve dhe konsumatori dhe një kopje e faturës duhet të dorëzohet konsumatorit.</p> <p>5. Në rastet e përcaktuara në paragrafin 4 këtij neni, nëse paraqitet nevoja për riparim apo</p>	<p>2. The seller must provide the conditions of sale of commodities and services in a clear, visible and legible manner and present them, at the time when they are displayed in the area of sales. Special conditions for certain categories of consumers offered by the trader, for a certain commodity must be clear, visible and legible and displayed, when time when they are displayed, at the points of sale of these commodities.</p> <p>3. The seller is prohibited from publishing any data or personal information of the consumer, to any third party without written consent and authorization of the consumer, except by a court order when the information is needed by the competent authorities for investigation of cases.</p> <p>4. Service provider for any repair and maintenance commodities must issue a consumer invoice with description of services and materials used for repair. The invoice must be signed by the service provider and consumer and a copy of consumer invoice shall be submitted to the consumer.</p> <p>5. In the cases specified in paragraph 4 of this Article, if repairing, additional work or</p>	<p>2. Prodavac treba da pruži uslove prodaje roba ili usluga na jasan, vidljiv i čitljiv način i da predstavi u momentu njihovog izlaganja na prodajnom prostoru. Posebni uslovi za određene kategorije potrošača koje pruža trgovac, za određene robe treba da budu jasni, vidljivi i čitki i da se prikažu u trenutku njihovog izlaganja na prodajnim mestima ovih roba.</p> <p>3. Prodavcu je zabranjeno objavljivanje podataka ili bilo koje lične informacije o potrošaču, nekon trećoj strani bez saglasnosti i pismenog ovlašćenja potrošača, osim sudskom odlukom kada su informacije potrebne nadležnim organima za istrage slučajeva.</p> <p>4. Davalac usluga za svaku popravku ili održavanje roba, treba da izda jednu fakturu potrošaču sa opisanim uslugama i materijalima upotrebljenim za popravku. Faktura treba da se potpiše od davaoca usluga i potrošača i jedan primerak fakture se predaje potrošaču.</p> <p>5. U slučajevima utvrđenim u stavu 4 ovog člana, ako se pojavi potreba za popravkom ili</p>
--	--	--



<p>punë shtesë apo instalimin e komponentëve të nevojshme, ofruesi i shërbimeve duhet të marrë pëlqimin me shkrim nga konsumatori, ose me anë të komunikimit në largësi, nëse kostoja e shërbimit rritet më shumë se 10 për qind e faturës totale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Ankesat e konsumatoreve ndaj shitësve ose ofruesve të shërbimeve</p> <p>1. Çdo shitës është i obliguar t'i mundësojë konsumatorit të paraqes ankesë me shkrim drejtpërdrejt, përmes postës, faksit ose me e-mail adresë.</p> <p>2. Shitësi ose ofruesi i shërbimeve me rastin e pranimit të ankesës nga konsumatori obligohet të jap përgjigje lidhur me ankesën në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të ankesës.</p> <p>3. Çdo shitës dhe ofrues i shërbimeve duhet të mban dhe ruan ankesat e konsumatorëve të paktën një vit nga data e marrjes së ankesave të konsumatorëve.</p>	<p>installation of components required is needed, the service provider must obtain a written consent from the consumer, or through distance communication, if the cost of service increases more than 10 percent of the total invoice.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Consumer complains towards sellers or service providers</p> <p>1. Each seller is obliged to enable the consumer to submit a written complaint directly, by mail, fax or through e-mail address.</p> <p>2. The seller or service provider upon receipt of a complaint by the consumer is obliged to answer regarding the complaint within 15 days of receiving the complaint.</p> <p>3. Each seller and service provider must keep and maintain consumer complaints at least one year from date of receipt of consumer complaints.</p>	<p>dotatnim poslom ili za instaliranjem potrebnih komponenti, davalac usluga treba da dobije pismenu saglasnost od potrošača, ili komuniciranje sa udaljenosti, ako se cena usluge poveća više od 10 procenata ukupne fakture.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Žalbe potrošača protiv prodavca ili davaoca usluga</p> <p>1. Svaki prodavac je obavezan da omogući potrošaču podnošenje pismene žalbe, direktno, poštom, faksom ili e-mail adresom.</p> <p>2. Prodavac ili davalac usluga u slučaju primanja žalbe od strane potrošača, obavezan je da da odgovor u vezi sa žalbom u roku od 15 dana od dana primanja žalbe.</p> <p>3. Svaki prodavac ili davalac usluga treba da drži i čuva žalbe potrošača najmanje godinu dana od dana primanja žalbe od potrošača.</p>
---	---	--



<p style="text-align: center;">Neni 9 Vendosja e Çmimeve të mallrave dhe shërbimeve</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Pricing of commodities and services</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Postavljanje cena roba i usluga</p>
<p>1. Shitësi duhet të vendos qartë, dukshëm dhe lexueshëm çmimin e shitjes me pakicë dhe shumicë dhe çmimin për njësi të mallrave apo shërbimeve të ofruara.</p> <p>2. Çmimi me pakicë dhe shumicë përfshin çmimin përfundimtar për çdo mall apo shërbim, ose për një sasi të caktuar të mallrave, duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar.</p> <p>3. Shitësi duhet ti garantoj konsumatorit se çmimi i paguar do të jetë i njëjtë me çmimin e ekspozuar sipas paragrafit 2 të këtij neni.</p> <p>4. Çmimi për njësi matëse do të thotë çmimi përfundimtar për njësi matëse, çmimi për kilogram, litër, metër, metër katror, metër kub të mallit ose disa njësi të tjera matëse duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar konform paragrafit 2 të këtij neni.</p> <p>5. Për mallrat e papaketuara, refuz çmimi për njësi matëse të mallit të ofruara në treg vendoset pranë mallit.</p>	<p>1. The seller shall establish a clear, visible and legible retail and wholesale price and unit price of commodities or services offered.</p> <p>2. The retail and wholesale price includes the final price for any commodity or service, or for a certain amount of commodities, including the value added tax.</p> <p>3. The seller must guarantee the consumer that the paid price will be equal with the price displayed under paragraph 2 of this Article.</p> <p>4. Price per measuring unit means the final price per measuring unit, the price per kilogram, liter, meter, square meter, cubic meter of commodity or several other measuring unit including the value added tax pursuant to paragraph 2 of this Article.</p> <p>5. For unpackaged commodities, the bulk price per measuring unit of the commodity offered on the market is placed near the commodity.</p>	<p>1. Prodavac treba da jasno, vidno i čitko postavi prodajnu cenu na malo i veliko i cenu za jedinicu roba ili pruženih usluga.</p> <p>2. Cena na malo i veliko obuhvata završnu cenu za svaku robu ili uslugu, ili za jednu određenu količinu roba, uključujući porez na dodatnu vrednost.</p> <p>3. Prodavac treba da garantuje potrošaču da će plaćena cena biti ista sa izloženom cenom, shodno stavu 2 ovog člana.</p> <p>4. Cena za mernu jedinicu znači konačnu cenu za mernu jedinicu, cena za kilogram, litar, metar, kvadratni metar, kubni metar robe ili nekoliko ostalih mernih jedinica uključujući porez na dodatnu vrednost u skladu sa stavom 2 ovog člana.</p> <p>5. Za neupakovane robe, nepakirani cena za mernu jedinicu proizvoda izloženih na tržište postavlja se ispred robe.</p>



<p>6. Për mallrat e para-paketuara, është e mjaftueshme vendosja e çmimit neto për njësi në qoftë se me rregullat tjera të veçanta në të dhënat për peshën neto, nuk është përcaktuar ndryshe.</p> <p>7. Çmimi i shitjes me pakicë dhe çmimi për njësi të para-paketuara i mallrave do të vendoset në ose pranë mallit, paketimit ose pikës së shitjes si dhe në raftet. Përveç çmimit sipas paragrafit 1 këtij neni nuk lejohet kurrfar çmimi tjetër, përveç në rastin e shitjes me aksion, uljes së çmimit apo me rastin e falimentimit të kompanisë.</p> <p>8. Shitësi duhet të vendos çmimin në mënyrë që të mos dëmtojë mallin.</p> <p>9. Dispozitat e paragrafit 8 të këtij neni nuk do të zbatohen për ankande publike dhe shitjen e veprave të artit, veprave antike si dhe shërbimeve të rregulluara me aktet tjera në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Çmimet në reklama</p> <p>Çmimi me pakicë i mallrave apo shërbimeve dhe çmimi për njësi i mallit që publikohen në reklama, duhet të jetë i njëjtë me çmimin e përcaktuar konform dispozitave të nenit 9</p>	<p>6. For pre-packaged commodities, it is sufficient to place the net price per unit. If the other special rules in the data for net weight do not set out otherwise.</p> <p>7. Retail selling price and price per unit of pre-packaged commodities shall be placed on or near the commodity, packaging or point of sale and on shelves. Besides the price, in accordance with the paragraph 1 of this Article, it is not allowed to cure another price, except in case of sale, discount of the price or in case of company's bankruptcy.</p> <p>8. The seller must place the price in order not to damage the commodity.</p> <p>9. The provisions of paragraph 8 of this article shall not apply to public auctions and sales of works of art, antique works and services regulated by other applicable laws.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Prices in advertising</p> <p>The retail price of commodities or services and price per unit of the commodity published in advertisements must be the same with the price set by the provisions of Article 9 of this</p>	<p>6. Za preupakovane robe, dovoljno je postavljanje neto cene po jedinici, ako ostalim posebnim pravilima u podacima za neto težinu, nije drugačije određeno.</p> <p>7. Prodajna cena na malo i cena za preupakovanu jedinicu roba, postaviće se na ili ispred robe, pakovanja ili prodajnog mesta kao i na rafovima. Osim cene shodno stavu 1 ovog člana nije dozvoljena nikakva druga cena, osim u slučaju akcije, sniženja cene ili u slučaju bankrotstva preduzeća.</p> <p>8. Prodavac treba da postavi cenu na taj način da ne ošteti robu.</p> <p>9. Odredbe stava 8 ovog člana ne sprovode se za javnu licitaciju i prodaju umetničkih dela, antičkih dela kao i usluga regulisnih ostalim aktima na snazi.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Cene na reklamama</p> <p>Cena na malo roba ili usluga i cena za jedinicu robe, koje se objavljuju na reklamama, treba da bude ista sa cenom utvrđenom u skladu sa odredbama člana 9</p>
---	---	--



<p>këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Pagesa e obligimeve financiare</p> <p>Detyrimet financiare që konsumatori paguan përmes bankës, postës apo institucioneve tjera financiare do të konsiderohet i paguar në datën kur institucioni i tillë të marrë urdhërpagesën e konsumatorit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Fatura</p> <p>1. Shitësi për çdo mall të shitur ose shërbim të ofruar për konsumatorin duhet të jap faturë e cila duhet të jetë e saktë, e pashlyeshme, e qarte, e dukshme dhe e lexueshme në letër apo formë elektronike.</p> <p>2. Shitësi i mundëson konsumatorit për të kontrolluar sasinë e faturuar në lidhje me mallin e blerë apo shërbimin e ofruar.</p> <p>3. Shitësi duhet t’u përmbahet kushteve të deklaruara dhe çmimit të shitjes me pakicë.</p> <p>4. Faturimi nuk lejon pagesë plotësuese përveç asaj që është cekur në faturë.</p> <p>5. Çmimet administrative dhe çmimet e</p>	<p>Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Payment of financial obligations</p> <p>Financial obligations that the consumer pays through bank, mail or other financial institutions shall be considered as paid on the date when such institution receives the consumer’s payment order.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Invoice</p> <p>1. The seller for every commodity sold or service provided to the consumer must provide an invoice which must be accurate, indelible, clear, visible and legible in paper or electronically.</p> <p>2. The seller allows the consumer to control the amount invoiced in connection with purchased commodity or service provided.</p> <p>3. The seller must comply with the declared conditions and retail price.</p> <p>4. Invoicing does not allow additional charge other than what is stated in the invoice.</p> <p>5. Administrative prices and prices of public</p>	<p>ovog zakona</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Plaćanje finansijskih obaveza</p> <p>Finansijske obaveze koje potrošač plaća preko banke, pošte ili ostalih finansijskih institucija, smatraće se isplaćene na dan kada takva institucija dobije platni nalog potrošača.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Faktura</p> <p>1. Prodavac, za svaku prodatu robu ili uslugu za potrošača, treba da izda fakturu koja treba da bude tačna, neizbrisiva, jasna, vidljiva i čitka na papiru ili elektronskoj formi.</p> <p>2. Prodavac omogućava potrošaču kontrolisanje fakturisane količine u vezi sa kupljenom robom ili pruženom uslugom.</p> <p>3. Prodavacse treba pridržavati deklariranih uslova i prodajne cene na malo.</p> <p>4. Fakturisanje ne dozvoljava dopunsko plaćanje osim onoga koje je navedeno na fakturi.</p> <p>5. Administrativne cene i cene javnih usluga</p>
---	--	--



<p>shërbimeve publike si energjia, uji dhe shërbimet e telekomunikimit rregullohen me ligje të tjera.</p> <p>6. Për shërbime tjera si transporti i udhetarve duhet të ipet fature ose bilet individuale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Etiketa</p> <p>1. Shitësi i mallrave dhe/apo shërbimeve duhet të sigurojë që mallrat që shet të jenë të pajisura me etiketë, e cila përmban informacione për prodhuesin dhe adresën e tij, emërtimin e mallit, sasinë, përbërjen, cilësinë, datën e prodhimit, afatin dhe mënyrën e përdorimit, mirëmbajtjes si dhe rrezikshmërinë nëse ekziston.</p> <p>2. Informacioni për etiketim për mallrat ushqimorë rregullohet me akt nënligjor.</p> <p>3. Shitësi nuk ka të drejtë të heqë ose të ndryshojë etiketën e mallit apo informacionet e tjera lidhur me mallrat e dhëna nga prodhuesi dhe/ose furnizuesi.</p> <p>4. Nëse natyra e mallit nuk e lejon vendosjen e etiketës, shitësi është i detyruar të sigurojë,</p>	<p>services such as electricity, water and telecommunications services are regulated by other laws.</p> <p>6. For other services such as transport of travelers, an invoice or individual ticket must be provided.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Label</p> <p>1. The seller of commodities and/or services must ensure that the commodities he sells are equipped with the label, which contains information about the manufacturer and his address, name of the commodity, quantity, composition, quality, production date, time and manner of use, maintenance, risk in case it exist.</p> <p>2. Labeling information for food products shall be regulated through a bylaw.</p> <p>3. The seller does not have the right to remove or change the label of commodities or other information relating to commodities provided by the manufacturer and / or supplier.</p> <p>4. If the nature of the commodities does not allow labeling, the seller is obliged to provide,</p>	<p>kao energjia, voda i usluge telekomunikacija regulišu se ostalim zakonima.</p> <p>6. Za ostale usluge kao što je prevoz putnika treba se izdati faktura ili pojedinačna karta.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Etiketa</p> <p>1. Prodavac roba i/ili usluga treba da obezbedi da robe koje prodaje budu snabdevene etiketama, koja sadrži informacije za proizvođača i njegovu adresu, naziv robe, količinu, sastav, kvalitet, datum proizvodnje, rok i način upotrebe, održavanje, opasnost ako postoji.</p> <p>2. Informacija za etiketiranje prehrambene robe reguliše se podzakonskim aktom.</p> <p>3. Prodavac nema pravo da ukloni ili da izmeni etiketu na robu ili ostale informacije u vezi sa robama datim od proizvođača i/ili dobavljača.</p> <p>4. Ako priroda robe ne dozvoljava postavljanje etikete, prodavac je obavezan da</p>
--	--	--



<p>sipas kërkesës së konsumatorit, informacionin në përputhje me pikën 1 të këtij neni, në mënyrë tjetër apo edhe përmes paraqitjes së dokumenteve përkatëse.</p> <p>5. Shitësi me rastin e vendosjes në treg të mallit obligohet të vendos etiketën, në të gjitha mallrat e paketuara.</p> <p>6. Për mallrat e papaketuara, refuz duhet të siguroj një udhëzues të përgatitur nga prodhuesi për mënyrën e përdorimit më të lehtë dhe më të sigurt, pastaj ti ofroj garancionin, udhëzime teknike, listën për serviset e autorizuar, një liste për paralajmërim nga rreziqet e mundshme gjatë përdorimit dhe një deklaratë të konformitetit të mallrave</p> <p>7. Etiketa duhet të jetë e shkruar qartë, dukshëm dhe e lexueshme në gjuhën shqipe dhe gjuhët tjera zyrtare.</p> <p>8. Përkthimi i të dhënave në gjuhën shqipe të vendosura në etiketë nga prodhuesi, për të bërë më të lehtë informimin e konsumatorit lidhur me sigurinë e përdorimit të mallit, në paragrafin 1 duhet të jetë identike me origjinalin.</p>	<p>upon request of the consumer, the information in accordance with paragraph 1 of this Article, in other way or by presenting the relevant documents.</p> <p>5. The seller when placing the commodity on market is obliged to put the label on all packaged commodities.</p> <p>6. For unpackaged commodities, bulk he must provide an instruction prepared by the manufacturer for the method of easier and safer use, then to offer guarantee, technical instructions, the list of authorized services, a list of warning on potential dangers during the use and a declaration of conformity of commodities.</p> <p>7. The label must be written clearly, visibly and legibly in Albanian and other official languages.</p> <p>8. Translation of data into Albanian, placed on the label by the manufacturer, in order to make the consumer information easier regarding the safe use of the commodity, in paragraph 1 shall be identical with the original.</p>	<p>obezbedi, prema zahtevu potrošača, informaciju u skladu sa tačkom 1 ovog člana, na drugi način ili putem podnošenja odgovarajuće dokumentacije.</p> <p>5. Prodavacu slučaju plasiranja robe na tržište obavezuje se da postavi etiketu, na svim upakovanim proizvodima.</p> <p>6. Za neupakovane robe, nepakirani treba da obezbedi jedno uputstvo pripremljeno od proizvođača o načinu što lakšeg sigurnog korišćenja, nakon toga da pruži garanciju, tehnička uputstva, listu za ovlašćene servise, jednu listu o upozorenjima od mogućih opasnosti tokom upotrebe i jednu deklaraciju o usaglašenosti roba.</p> <p>7. Etiketa treba da bude jasno ispisana, vidljiva i čitka na albanskom jeziku i ostalim službenim jezicima.</p> <p>8. Prevod podataka na albanskom jeziku postavljen na etiketi od strane proizvođača, kako bi se lakše informisao potrošač u vezi sa sigurnošću korišćenja robe, u stavu 1 treba da bude identičan sa originalom.</p>
--	--	---



Neni 14 Paketimi	Article 14 Packaging	Član 14 Pakovanje
